



DEZINSEKTIMI

Furrtarja gjermane

Më e rëndësishmja

Furrtarja gjermane është një parazit që mund të merret nëpërmjet gjatë lëvizjes së materialeve.

- Ajo shumohet në ndërtesa të ngrohura dhe, përmes fekaleve dhe baktereve të të vjellave, mund të transmetohet tek ushqimet dhe njerëzit.
- Ajo është aktive gjatë natës dhe preferon ambiente të ngrohta dhe me lagështirë.
- Një infestim mund t'i ndodhë kujtdo dhe nuk lidhet me kushtet jo higjienike.
- Kundër infestimit nevojitet vetëm një dezinfektim profesional. Një spërkatës kundër insekteve nuk e mënjanon infestimin.
- Në rast dyshimi, duhet patjetër të mblidhni parazitë dhe t'i identifikoni nëpërmjet specialistit.

Pamja

- Në moshë të rritur ajo ka gjatësi 9-15 mm, ngjyrë kafe, trup të shtypur dhe antena të gjata.
- Ka dy shirita të gjatë dhe të zinj në qafë, çka e dallon nga furrtarja e pyllit, e cila nuk është e dëmshme. Furrtarja e pyllit nuk i ka këto shirita.
- Nuk mund të fluturojë.



Furrtarja gjermane, foto: Reiner Pospischil

- Fekalet – kokrriza të vogla, të errëta – duken si kokrra kafeje.



Fekale të furrtares dhe mbetje të vezëve, foto: UGZ

- Paraziti i vogël (larva): Në varësi të moshës, ka gjatësi 2-9 mm, nuk ka flatra, ka ngjyrë më të errët se paraziti i rritur, por pamje të ngjashme.



Furrtarja gjermane e rritur (majtas) me dy larva me moshë të ndryshme, foto: UGZ

Mënyra e jetesës

- Në Zvicër jeton vetëm në ndërtesa të ngrohura, në banesa gjendet kryesisht në kuzhinë dhe në banjë.
- Është aktive gjatë natës, kur sheh dritë largohet shpejt dhe fshihet në vende të çara.
- Preferon të qëndrojë në vende të errëta, me lagështirë dhe të ngrohta: Pajisje elektroshtëpiake si p.sh. frigoriferi, makina larëse, makineria e kafesë etj.
- Ha çdo gjë: Mbeturinat në koshin e plehrave, thërrime buke, spërka yndyre.
- Mund të shfaqet edhe në banesa shumë të pastra.

Zhvillimi

- Femrat pjellin qeska me vezë, ku secila përmban mesatarisht 36 vezë.
- Në temperaturë 24°C, veza shndërrohet në një furrta të rritur për rreth 100 ditë.

Shpërndarja

- Sot është e shpërndarë në të gjithë botën.
- Ajo gjendet në sektorin e hotelerisë, në industrinë ushqimore, në qendra tregtare, në pishina dhe në spitale, por edhe në banesa.

Si vijnë furrta në banesë?

- Ato merren pa dashje nga jashtë, nëpërmjet valixheve, nga mobilie të vjetra, materiale ambalazhi ose nga vendi i punës.
- Kur ndodhen në banesë, ato enden nga një banesë në tjetrën, p.sh. nëpërmjet tubacionit të ajrit dhe ujit.
- Në përgjithësi, probleme me furrta kanë disa banesa ose i gjithë pallati.

Kuptimi dhe dëmet

- Furrta nuk shfaqen asnjëherë nga papastërtia dhe nuk janë tregues të mungesës së pastërtisë.
- Ato janë johigjienike, mund të transmetojnë baktere sëmundjesh dhe duhet të luftohen.
- Fekalet e tyre dhe mbetjet e lëkurës mund të shkaktojnë alergji.

Luftimi

- Furrta nuk zhduken vetvetiu.
- Edhe pastrimi nuk i zhduk.

- Pyesni fqinjët nëse kanë probleme me furrta dhe lajmëroni administratorin e pallatit në lidhje me infestimin.
- Mos u përpini t'i luftoni vetë me spërkatës insektesh, sepse kjo mund t'i shpërndajë furrta në të gjithë banesën ose pallatin.
- Furrta duhet të luftohen njëherësh në të gjithë pallatin.
- Luftimi të bëhet vetëm nga një kompani dezinfestimi me licencë të posaçme të miratuar.
- Qëllimi duhet të jetë i përcaktuar qartë: asgjësim i plotë në të gjithë pallatin.

Kush i merr përsipër kostot?

- Në rast infestimi në më shumë se një banesë në pallat, administrata e pallatit duhet të angazhojë një kompani të specializuar për ta luftuar. Të gjitha banesat duhet të kontrollohen për prani furrtaresh.
- Kostot nuk duhet t'i kalohen në ngarkesë qiramarrësve. Për këtë, shihni fletëpalosjen tonë *Situata ligjore në rast infestimi*. Në nenin 256, nenin 257, germa "f", "g", "h"; nenet 258 dhe 259 përcaktohet situata ligjore për objektet e banimit.

Ju ndihmojmë për zgjidhje

Na telefononi, na i dërgoni ose sillni insektet për t'i identifikuar. Konsulenca jonë është falas dhe vetëm për banorët e qytetit të Cyrihut.

Departamenti i Konsulencës për Dezinfestim
Isabelle Landau Lüscher, Dr. Gabi Müller, Marcus Schmidt

Orari i telefonatave dhe takimeve personale për banorët e qytetit të Cyrihut:

Walchestr. 31, kati i 2, Zyra 232

Telefon 044 412 28 38

E hënë – E premte: ora 13:30 – 14:30

Për dërgimin e letrave: Walchestrasse 31
Postfach 3251, 8021 Zürich

Për dërgimin e paketave: Walchestrasse 31
8006 Zürich

ugz-bsb(at)zuerich.ch

www.stadt-zuerich.ch/schaedlingsbekaempfung